

V E N D I M
Nr. 389, datë 8.8.2002

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I
RISTRUKTURIMIT TË UZINËS MEKANIKE NË GRAMSH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 112 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative", të nenit 4 të ligjit nr.8571, datë 27.1.2000 "Për miratimin e dokumentit të politikës së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë", të nenit 8 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të nenit 29.1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2002", ndryshuar me ligjin nr.8903, datë 23.5.2002, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Uzina mekanike në Gramsh t'i nënshtrohet procesit të ristrukturimit.
2. Punonjësit e kësaj uzine, që mbeten të papunë nga ky proces, të trajtohen financiarisht për periudhën nga 1.1.2002 deri më 31.12.2002, me pagë mujore prej 13 596,4 lekësh, ku përfshihen dhe sigurimet e detyrueshme.
Pagesat të bëhen njëherazi nga zyra përkatëse e punësimit, me fondet që, sipas pikës 5 të këtij vendimi, i janë shtuar Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.
3. Kjo periudhë pagese t'u njihet këtyre punonjësve si vjetërsi në punë, për efekt pensioni, dhe të shënohet e tillë në librezën e punës pasi të bëhet pagesa e kontributit për sigurimet shoqërore, në përputhje me ligjin.
4. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë punonjësit të cilët në datën 31.12.2001 kanë qenë në marrëdhënie pune, pa ndërprerje, ose janë trajtuar me pagesë gatishmërie në uzinën mekanike Gramsh, për një periudhë kohe jo më pak se një vit.
5. Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, në zërin "Mallra e shërbime", t'i pakësohet fondi prej 16 642 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë) lekësh. Ky fond t'i shtohet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në buxhetin e miratuar për vitin 2002.
6. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano